

Ditëlindjet

Pëllumbesha Zotaj 2 Janar, Arsena Gjipali 6 Janar,
Vangjel Findiku 11 Janar, Elvis Rama 31 Janar.

Ju urojmë Gëzuar Ditëlindjen duke falenderuar Perëndinë për dhuratën e bukur të jetës! Jemi të bekuar që jeni pjesë e familjes tonë! Zoti ju bekoftë!

Shpirtëlindjet

Bledar Valca 15 Janar.

Ju urojmë Gëzuar Ditëlindjen Shpirtërore! Dita që vendosët të visheni me Krishtin ishte dita më e rëndësishme e jetës tuaj!

Veprimtaritë e Muajit Janar

Takimet tona

E Diel	Studimi biblik i Fëmijëve	Ora - 10:00
	Studimi Biblik	Ora - 10:00
	Takimi i të Rinjve	Ora - 10:00
	Shërbimi i Adhurimit	Ora - 11:00
E Martë	Shërbimi i Mbrëmjes	Ora - 18:00
	Takimi i Motrave	Ora - 18:00
E Mërkurë	Takimi i mesjavës	Ora - 18:00

Pjesëmarrja për datën	6/1/2019	50
Kontributi për datën	6/1/2019	20,360 leke

Shërbimi i Adhurimit

	13 Janar	20 Janar
Këngët	K. Findiku	A. Muca
Lutja e parë	A. Muca	A. Muca
Studimi biblik	S. Haxhiu	S. Haxhiu
Lutja e dytë	E. Qirjaqi	A. Veshti
Predikimi	S. Haxhiu	E. Qirjaqi
Darka e Zotit	D. Sula	B. Valca
Oferta	V. Findiku	E. Rama
Lutja e tretë	A. Hyka	Sh. Patria
Predikimi pasdite	A. Lleshi	Këngë
E Mërkurë	B. Valca	B. Valca

I dashur mik / E dashur mikeshë,

Faleminderit që je bashkuar me ne në adhurimin e Perëndisë. Ky Perëndi dashurie dhe drejtësie, dëshiron të ketë një marrëdhënie me ty. Për këtë, Ai dërgoi Birin e Tij, Jezus Krishtin të vdesë në kryq për mëkatet tona dhe të ringjallet për drejtësimin tonë. Edhe ti mund të hysh në marrëdhënie me Të nëse e beson planin e Tij për jetën tënde, duke hequr dorë nga jeta e jetuar pa Të për t'ju kthyer Atij me gjithë mendje e zemër, duke e deklaruar besimin tënd tek Jezusi dhe duke u pagëzuar për faljen e mëkateve. Ai premtan se jo vetëm do të falë mëkatet por do të japë dhe Frymën e Tij si dhuratë për të ndihmuar të jetosh për Të cdo ditë. Në fund, nëse i qëndron besnik Atij, Ai do të të japë kurorën e jetës dhe do të vendosë të jetosh në prezencë të Tij, përgjithmonë.

Të krishterët, si ndjekës të Jezusit duhet ta jetojnë besimin e tyre përmes veprimtarive të përditshme duke i ofruar jetët e tyre si një flijim të gjallë për Zotin dhe kur mblidhen së bashku në Ditën e Parë të Javës e shprehin mirënjohjen për Perëndinë duke e përlehtëuar Atë me frytin e buzëve dhe melodinë e zemrës, duke u lutur, duke marrë nga buka dhe fryti i hardhisë në përkujtim të vdekjes së Tij, duke dëgjuar vullnetin e Tij për jetën e tyre përmes mësimit dhe predikimit të Fjalës së Tij dhe duke kontribuar financiarisht nga të ardhurat e tyre.



KISHA E KRISHTIT, TIRANË

Rruga Maliq Muça, Nr. 37 Tel. +355-4 222-80-99

13 Janar 2018

Ne jemi një grup njerëzish me prejardhje e moshë të ndryshme që mblidhemi për të adhuruar dhe punuar së bashku për lavdi të Perëndisë, me ndihmën e të cilit përpiqemi të japim dhe të bëjmë më të mirën tonë.

E duam Perëndinë për atë që ka bërë për ne nëpërmjet Jezusit. Përpiqemi të imitojmë Krishtin dhe ta ndjekim Atë deri në fund të ditëve tona. Besojmë në autoritetin absolut të Biblës dhe në faktin që ajo është tërësisht e frymëzuar.

Ju ftojme të bashkoheni me ne gjatë javës në takimet e gëzueshme të atyre që e duan Perëndinë. Është e mrekullueshme të jesh i Krishterë dhe pjesëtar i familjes së Perëndisë!

Cilën rrugë të marr?

Atëhere Jezusi u tha dishepujve të vet, “Në qoftë se dikush don të vijë pas meje, ta mohojë vetveten, ta marrë kryqin e vet dhe të më ndjekë. Sepse ai që do të dojë ta shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do ta humbasë jetën e vet për hirin tim do ta gjejë atë” Mateu 16:24,25

Kohë më parë, kur unë ia dhashë zemrën Krishtit, u ula tek vendi i shoferit dhe prisja që Ai të ishte ndihmësi im.

Me mirënjohje e ftova Perëndinë të ulej afër meje, të ishte bashkëudhëtari im në këtë udhëtim që quhet jetë. E doja Perëndinë në jetën time, të më ndihmojë të bëja atë që unë nuk e bëja dot vetë, duke pritur që ai të jetë me mua për të më zbutur vështirësitë dhe për të më sheshuar rrugën.

Por Jezusi tha, "Në qoftë se dikush don të vijë pas meje, të më ndjekë..."

Në pjesën më të madhe të jetës sime, kam pasur prirjen të isha vetë në kontroll të saj. Është më e lehtë në këtë mënyrë, ose të paktën kështu i thoja vetes se ishte. Duket e rrezikshme të lësh dikë tjetër të të udhëheqë në jetën tënde, edhe nëse ky është Perëndia i Universit, i cili më njeh më mirë se sa e njoh unë veten time.

Për një kohë të gjatë, frika nuk më lejonte t'ia jepja çelësat Shpëtimtarit tim. Nga Frika se çfarë mund të bëjë. Nga Frika se ku mund të më çonte. Nga Frika se çfarë mund të më kërkonte të bëjë. **Isha kaq shumë i fokusuar tek Vetja ime sa që nuk mund ta pranoja ATE të ishte me mua.**

Perëndia thërret secilin prej nesh të heq duart nga timoni, të dorëzojë çelësat e makinës dhe ta lërë Perëndinë ta ngasë atë. **Të dorëzuarit tek tjetri nuk është e lehtë dhe frika mund të na pushtojë.**

Por heqja dorë nga kontrolli i jetës sonë, mund të na çojë në një vend ku do të ketë liri, gëzim dhe paqe në besimin tek Perëndia. Kjo është një rrugë e rrahur më pak.

Kërkoji Perëndisë të të zbulojë atë pjesë të jetës të cilën po e mban fort nën kontroll, ndoshta ti e di kush është ajo pjesë. Merr një hap kurajoz dhe lërja kontrollin e saj Perëndisë.

Kërkesa për Lutje

-Falenderojmë Perëndinë për përgjigjet e lutjeve tona.

-Le të lutemi për të gjitha **Kishat e Krishtit në Shqipëri**, që të rriten në numër dhe në besim.

-Le të mbajmë në lutjet tona **Kamberin, burrin e motrës tonë Rrufeja**. Ai ka qenë shumë sëmure këto kohët e fundit.

-Të mbajmë në lutje **dajën e motrës sonë Marjana**, i cili është sëmure rëndë nga zemra dhe ndodhet i shtruar në reaminacion.

-Të mbajmë në lutje **mamanë e motrës sonë Ellen**. Gjendja e saj shëndetsore është përmirësuar por vazhdon të ketë nevojë për lutjet tona.

-Të mbajmë në lutje **Eroldin, djalin e motrës tonë Arsen**a, i cili ka qenë sëmure me temperaturë.

-Të lutemi për **prindërit e vëllait tonë Lee Allen**. Ata ndodhen në një situatë të rëndë shëndetsore dhe kanë nevojë për lutjet tona. Le të lutemi gjithashtu edhe për vëllain tonë Lee, që ai ta përballojë këtë situatë në ndihmën që i jep atyre.

-Një lutje të veçantë për **familjen e Karl Mitchell** i cili ndërroi jetë para disa ditësh. Ai ka shërbyer edhe në kishën tonë dhe ka dhënë eksperiencën e tij. Perëndia ngushëlloftë zemrat e familjarëve të tij.

-Le të mbajmë në lutjet tona **situatën në Shqipëri si dhe të gjithë drejtuesit politikë të Shqipërisë** (1 Timoteut 2:1-4).

-Lutemi për të gjitha familjet e Bashkësisë tonë të cilat ndodhen në kushte të vështira ekonomike. Ne lutemi gjithashtu për të gjithë ata të cilët po kërkojnë për punë.

Këndi i Lajmërimeve

* **Të gjitha kërkesat për lutje dhe njoftime, mund t'i drejtoni duke telefonuar tek zyrat në numrin 04/222-80-99 ose në adresën: weitirana@gmail.com, deri të enjten paradite.**

* **Të dielave në mëngjes, vëlla Sokoli** po na drejton në një studim të librit të **Zakarias** në sallën e madhe. Ndërkohë që **të rinjtë** mblidhen në pjesën e poshtme të ndërtesës. Gjatë kësaj kohe ka dhe tre klase të ndryshme për **fëmijët** sipas moshave **bebe, parashkollore** dhe **shkollore**.

* **Motrat** mblidhen **të martave** në orën **18:00**. Studimi i tyre po drejtohet nga motër **Vasilika**.

* Gjatë studimit të mesjavës jemi duke reflektuar nga **1 Timoteut**. Në këtë studim të hollësishëm, Pali i mëson nxënësit të tij se si duhen bërë gjërat në kishën ku ai shërben. Vëlla **Bledi** po na drejton në këtë studim.

* Takimi i studentëve dhe profesionistëve të rinj është të enjten në ora 18:30. Nëse i përket këtij grupi je i ftuar. Nëse njeh dikë, nxite që të vijë.

* **Të dielën e ardhshme pasdite, do të kemi kohën tjetër ku do të jemi të përqendruar tek e këndura. Le të këndojmë më shumë e më mirë, për lavdi të Atij që meriton lavdi.**

At qiellor, unë e di që ky udhëtim të cilën unë bëj, është një udhë e vështirë dhe do të jetë e papërfunduar deri në momentin që unë të ndjej praninë Tënde. Largoji duart e mia nga timoni i saj dhe më mëso si të eci në këtë udhë me besim, i dorëzuar dhe i nënshtruar ndaj vullnetit Tënd. Amen.